EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8320
E shtunë, 13 qershor 2026
Çmimi 0. 50 €

I jepet lamtumira komandantit të UÇK-së, Sahit Jashari

FAQE 5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUSH ME KË?
QËNDRIMET E QARTA, POR PAZARET ENDE LARG

FAQE 4-5

Arben Hoti (RFE/RL)

Pas një viti e gjysmë paqëndrueshmëri institucionale, zgjedhjet e 7 qershorit kanë hapur një fazë të re politike në Kosovë, por jo menjëherë edhe procesin e formimit të institucioneve. Për këtë të fundit, partitë politike sinjalizojnë se do të duhet ende kohë. Lëvizja Vetëvendosje (LV), e cila ka dalë forca e parë politike, thotë se nuk do të ketë negociata zyrtare për koalicione të mundshme para përfundimit të numërimit edhe të votave të kandidatëve për deputetë. Në këtë fazë, vetëm Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) shpreh qëndrim të qartë për një koalicion pa LV-në, ndërsa subjektet tjera politike lënë të hapur mundësinë e bashkëpunimit mes tyre

LIDERËT POLITIKË KUJTOJNË SAKRIFICËN PËR LIRI NË 27-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË KOSOVËS

F. 3

NATO-ja THOTË SE DO TA ZVOGËLOJË PRANINË NË KOSOVË, SHEH PËRMIRËSIM TË SITUATËS SË SIGURISË

F. 3

AKTUALE

TRUMPI NJOFTON PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES ME IRANIN, THOTË SE DO TË NËNSHKRUHET SË SHPEJTI

F. 2

MAVRAJ NË 27-VJETORIN E ÇLIRIMIT: PA NATO-n NUK DO TË ÇLIROHESHIM, PA UÇK-në NUK DO TA KISHIM NATO-n NË KOSOVË

F. 7

KURTI: ZGJEDHJA E PRESIDENTIT KËRKON BASHKËPUNIM ME OPOZITËN

F. 5

EKONOMI

TURIZMI GJENEROI MBI 248 MILIONË EURO NDIKIM EKONOMIK GJATË VITIT 2025

F. 8

NË TIRANË MBAHET KONFERENCA "AUDITUES TË PËRGATITUR PËR TË ARDHMEN", PJESË E SAJ EDHE ZKA-ja

F. 8

SPORT

ADEMI NË CEREMONINË HAPËSE TË KUPËS SË BOTËS: NJË DITË EDHE KOSOVA DO TA SYNOJË MAJËN E FUTBOLLIT

F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

TRUMPI NJOFTON PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES ME IRANIN, THOTË SE DO TË NËNSHKRUHET SË SHPEJTI

Uashington, 12 qershor - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se është arritur një "marrëveshje e madhe" me Iran për t'i dhënë fund luftës në Lindjen e Mesme dhe se ajo mund të nënshkruhet këtë fundjavë, ndoshta në Evropë. "Ne sapo arritëm një marrëveshje të madhe për luftën me Iranin", u tha Trump gazetarëve në Zyrën Ovale më 11 qershor.

Megjithatë, ai shtoi se marrëveshja ende është "subjekt i finalizimit të dokumenteve, gjë që duhet të përfundojë gjatë ditëve të ardhshme dhe me gjasë do të ketë një nënshkrim, ndoshta në Evropë".

I pyetur nga gazetarët nëse lideri suprem i Iranit, Mojtaba Khamenei, e ka miratuar marrëveshjen, Trump tha: "Sipas asaj që kuptoj unë, përgjigjja është po".

Trump e përshkroi marrëveshjen si "një memorandum mirëkuptimi shumë të fuqishëm", duke shtuar se ajo ishte "disi konceptuale, por është diçka që do të realizohet". "Ne kemi një marrëveshje sipas së cilës Irani nuk do të ketë kurrë armë bërthamore, që ishte edhe qëllimi kryesor i gjithë asaj që duhej të kalonim për të arritur deri këtu. Pra, është një gjë shumë e madhe", u tha presidenti Trump gazetarëve.

Presidenti amerikan tha se nuk do të mund të merrte pjesë personalisht në ceremoninë e nënshkrimit, por shtoi se këtë mund ta bënte nënpresidenti JD Vance.

Megjithatë, zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit, Esmaeil Baghaei, u duk që minimizoi pritjet për një nënshkrim të shpejtë, duke deklaruar se Irani ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar rreth një marrëveshjeje.

Ai shtoi se janë finalizuar shumë detaje, por se "amerikanët vazhdojnë të ndryshojnë qëndrimet e tyre", sipas agjencisë iraniane të lajmeve Tasnim. Lidhur me këtë çështje nuk ka pasur një deklarim zyrtar nga Qeveria.

Trump ka deklaruar shpesh se një marrëveshje me Iran ishte afër që të arrihej e që ka për qëllim dhënien fund të luftimeve, negociatat kanë dështuar vazhdimisht pa arritur një marrëveshje përfundimtare, duke çuar në kërcënime të reja dhe sulme ajrore nga SHBA-ja, Irani dhe Izraeli.

Zyra e kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, tha se ishte mirënjohëse për çdo marrëveshje të negociuar nga Trumpi, por theksoi se Izraeli nuk është palë në memorandumin e mirëkuptimit.

Trump tha se edhe Ngushtica e Hormuzit, një rrugë ujore jetike që Irani praktikisht e ka mbyllur pas fillimit të luftës më 28 shkurt, do të hapet "sapo ta kemi nënshkruar" marrëveshjen. "Ngushtica do të hapet zyrtarisht sapo të nënshkruajmë, gjë që mund të ndodhë shpejt, shumë shpejt, ndoshta gjatë fundjavës në Evropë", tha Trump.

Ai po ashtu tha se kishte biseduar me udhëheqës në rajon, përfshirë aleatë në Gjiri Persik dhe Netanyahun, duke shtuar: "E gjithë Lindja e Mesme është shumë e lumtur".

Njoftimi i fundit për një marrëveshje të mundshme erdhi disa orë pasi Trump njoftoi se kishte anuluar sulmet që paralajmëroi se SHBA-ja do të kryente mbrëmjen e 11 qershorit ndaj Iranit. "Bazuar në faktin se diskutimet me Republikën Islamike të Iranit janë ngritur në nivelin më të lartë të udhëheqjes iraniane dhe janë miratuar, unë, si president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kam anuluar sulmet dhe bombardimet e planifikuara ndaj Iranit këtë mbrëmje", shkroi Trump në Truth Social më 11 qershor.

Udhëheqësi amerikan shtoi se "diskutimet dhe pikat finale" janë miratuar nga Shtetet e Bashkuara, Izraeli, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katari, Turqia, Pakistani, Bahrejni, Kuvajti, Jordania, Egjipti dhe shtete të tjera. "Bllokada detare do të mbetet në fuqi të plotë deri sa ky transaksion të finalizohet, koha dhe vendi i nënshkrimit do të njoftohen së shpejti", tha ai.

Pak kohë para këtyre deklaratave të Trumpit, Mohammad Baqer Qalibaf, kryetar i Parlamentit të Iranit, paralajmëroi SHBA-në që të mos përfshihet në një "moçal pa fund". "Strategjitë e gabuara dhe vendimet e nxituara do ta rikthejnë gjithë situatën në një drejtim edhe më të keq, do të shpërthejnë infrastrukturën energjetike dhe tregjet, si dhe do të krijojnë një moçal pa fund në të cilin do të mbeteni të bllokuar për vite me radhë", shkroi Qalibaf në X.

Gjatë 11 qershorit, Trump kishte deklaruar se Shtetet e Bashkuara do të kryenin sulme të reja ushtarake kundër Iranit.

Ai këtë paralajmërim e bëri teksa Uashingtoni dhe Teherani shkëmbyen sulme për të dytën ditë me radhë më 10 qershor, duke shënuar një nga përshkallëzimet më serioze që kur ka hyrë në fuqi në prill një armëpushim i brishtë mes palëve.

Nga rihapja e plotë e Ngushticës së Hormuzit te lehtësimi i sanksioneve, zbulohen pikat e marrëveshjes mes SHBA-së dhe Iranit për fundin e luftës

Protokolli i marrëveshjes mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit, të cilin Presidenti amerikan, Donald Trump pritet ta nënshkruajë së shpejti, parashikon rihapjen e plotë të Ngushticës së Hormuzit pa taksa, si dhe lehtësimin e sanksioneve kundër Iranit, në varësi të përpjekjeve të Teheranit për respektimin e marrëveshjes.

Sipas raportimit të Axios, që citon një diplomat anonim nga një vend ndërmjetësues dhe një zyrtar amerikan, teksti i protokollit do të zgjasë gjithashtu armëpushimin me 60 ditë, duke përfshirë edhe zonën e Libanit, për t'i hapur rrugë negociatave mbi programin bërthamor iranian.

Megjithatë, Irani ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar për nënshkrimin e marrëveshjes. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme iraniane, Esmail Baqaei, deklaroi për mediat shtetërore se Teherani po shqyrton ende kushtet e propozuara.

Përgatitjet për ceremoninë e nënshkrimit duket se po avancojnë. Axios raporton se katër aeroplanë transporti të tipit C-17 të Forcave Ajrore Amerikane u nisën drejt Evropës me materiale logjistike, duke pritur një udhëtim të mundshëm të zëvendëspresidentit amerikan J.D. Vance në Gjenevë.

Ceremonia e nënshkrimit mund të zhvillohet brenda ditëve në vijim, nëse të dyja palët arrijnë marrëveshjen përfundimtare.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

NATO-JA THOTË SE DO TA ZVOGËLOJË PRANINË NË KOSOVË, SHEH PËRMIRËSIM TË SITUATËS SË SIGURISË

Prishtinë, 12 qershor - Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, gjenerali i Forcave Ajrore amerikane, Alexus G. Grynkewich, tha se Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) gradualisht do të përshtatë forcën për mbështetjen e misionit të saj paqeruajtës në Kosovë, KFOR, gjatë vitit të ardhshëm, për shkak të, siç tha ai, përmirësimit të situatës së sigurisë në vend. "NATO dhe KFOR-i janë të përkushtuar për sigurinë në Kosovë", tha komandanti Grynkewich përmes një njoftimi më 12 qershor. "Është ky angazhim që ka çuar në rritjen e stabilitetit, teksa organizatat e sigurisë në Kosovë janë bërë më të afta. Kushtet aktuale ofrojnë mundësi për të optimizuar madhësinë dhe pozicionimin e KFOR-it", shtoi ai.

Radio Evropa e Lirë iu drejtua me pyetje NATO-s për të mësuar se për çfarë shkalle të zvogëlimit të trupave bëhet fjalë.

Një zëdhënës nga Selia Supreme e Forcave Aleate në Evropë tha për Radion Evropa e Lirë se kjo çështje "nuk ka të bëjë me numrat [e trupave], por me optimizim, ka të bëjë me ofrimin e sigurisë për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë, dhe më gjerësisht, të rajonit".

Lidhur me njoftimin e 12 qershorit të NATO-s, Radio Evropa e Lirë ka kërkuar koment edhe nga Ministria e Mbrojtjes së Kosovës.

Ndërkaq, pyetje janë dërguar edhe në Departamentin amerikan të Mbrojtjes* për të kuptuar qëndrimin e ShBA-së për këtë vendim dhe nëse trupat amerikane do të jenë pjesë e planifikimeve të NATO-s për përshtatje të forcës në KFOR.

Muajt e fundit ka pasur raportime dhe diskutime për mundësinë që SHBA-ja të rishqyrtojë praninë e trupave të saj në misionet e NATO-s, përfshirë në KFOR.

Megjithatë, Pentagoni i ka thënë më herët Radios Evropa e Lirë se nuk ka ndonjë njoftim për ndryshim të vendosjes së forcave amerikane.

Radio Evropa e Lirë mëson se numri i trupave të KFOR-it pritet që gjatë vitit të ardhshëm të rikthehet në nivelet e para vitit 2023.

Në atë vit, për shkak të tensioneve në veri të Kosovës, aleanca kishte bërë dislokimin e afër 1.000 trupave shtesë në Kosovë.

Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë është vendosur më 1999 në vend. Nga afër 50.000 trupa sa ishin dislokuar në atë vit, pas përfundimit të luftës, në Kosovë aktualisht janë rreth 4.600 trupa paqeruajtëse të KFOR-it nga shtete të ndryshme.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe Misionit për Sundim të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX. Ky mision paqeruajtës po ashtu ka përgjegjësinë e sigurisë përgjatë kufirit të Kosovës me Serbinë.

Në njoftimin e NATO-s - që vjen në përvjetorin e 27-të të hyrjes së trupave të saj në Kosovë, pas fushatës ajrore të aleancës mbi caqet serbe - u tha se situata e sigurisë ka vazhduar që të përmirësohet në vitet e fundit. Për këtë arsye, në janar NATO-ja ndaloi dislokimin e forcave rezervë në KFOR pas pothuajse dy vjetësh të rotacionit të vazhdueshëm. "Teksa situata e sigurisë në Kosovë mbetet përgjithësisht stabile, NATO do të optimizojë praninë e KFOR-it dhe gradualisht do të përshtatë forcën e tij aktuale gjatë vitit të ardhshëm", u tha në njoftimin e aleancës ushtarake perëndimore.

Ndryshimet do të ndodhin gradualisht në përputhje me kushtet në terren dhe ato mund të zhbëhen, nëse është e nevojshme, tha NATO.

Aleanca ushtarake perëndimore kujtoi se kishte rritur numrin e dislokimeve për pothuajse 1.000 trupa shtesë pas tensioneve dhe dhunës më 2023, përfshirë edhe "sulmeve të pajustifikuara ndaj paqeruajtësve të KFOR-it në Zveçan". Ky dislokim, sipas NATO-s, ishte më i madhi në mbi një dekadë.

Më 29 maj të vitit 2023, 93 pjesëtarë të KFOR-it kishin pësuar lëndime pas përleshjes me protestuesit serbë, të cilët po kundërshtonin marrjen e detyrës të kryetarëve shqiptarë në katër komunat në veri, të banuara me shumicë serbe. Të lënduar nga kjo përplasje pati edhe në anën e protestuesve.

Deri më tani, për dhunën në Zveçan janë dënuar disa persona.

Përveç ofrimit të sigurisë në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, KFOR-i ka edhe rol në ofrimin e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës.

Përmes një zotimi të vitit 2013, Kosova nuk mund të dërgojë Forcën e Sigurisë së Kosovës - që është në proces të transformimit në ushtri - në veri, pa pëlqimin paraprak të misionit të KFOR-it.

Ky angazhim ishte dhënë përmes një letre që ish-kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, i kishte drejtuar sekretarit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen. Ai mbetet në fuqi sot e kësaj dite, pavarësisht ndryshimeve në mandatin e FSK-së.

NATO tha po ashtu se vazhdon të mbështesë dialogun për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë - që zhvillohet nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian - duke u bërë thirrje palëve që të zgjidhin mosmarrëveshjet dhe të arrijnë një zgjidhje që respekton të drejtat e të gjitha komuniteteve. "Kjo është kyç për siguri afatgjatë në Kosovë dhe stabilitet në rajon", u tha në njoftimin e KFOR-it.

Gjenerali Grynkewich po ashtu tha se NATO-ja është e përkushtuar për Ballkanin Perëndimor, të cilin e cilësoi si rajon me rëndësi strategjike për aleancën, siguria e të cilit, sipas tij, lidhet direkt me sigurinë e zonës euroatlantike, duke shtuar se NATO nuk do të lejojë që të ketë vakum të sigurisë".

I JEPET LAMTUMIRA KOMANDANTIT TË UÇK-SË, SAHIT JASHARI

Skenderaj, 12 qershor - Të premten në varrezat e lagjes Jashari në Prekaz i është dhënë lamtumira e fundit komandantit të UÇK-së, Sahit Jashari, i cili ndërroi jetë të enjten.

Me rastin e ndarjes nga jeta të komandantit të UÇK-së, Sahit Jashari, komuna e Skenderajt është përkujdesur për ceremoninë e varrimit, ku fillimisht janë bërë homazhe pranë arkivolit në Palestrën "Ilaz Kodra". Gjithashtu është mbajtur edhe mbledhje komemorative, ku është vlerësuar se Sahit Jashari ishte një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftëtar i orëve të para dhe bashkëluftëtar besnik i Komandantit Legjendar Adem Jashari.

I përndjekur e i dënuar nga regjimi i Millosheviqit, ai qëndroi i palëkundur në rrugën e lirisë. Në Epopenë e lavdishme të 5, 6 dhe 7 marsit 1998, ai dha 13 anëtarë të ngushtë të familjes në altarin e lirisë, duke e vulosur me gjak rrugën e Kosovës drejt çlirimit. "Në këto momente të vështira, në emër të qytetarëve të Skenderajt, i shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes Jashari, miqve, bashkëluftëtarëve, dashamirëve dhe të gjithë atyre që e kanë njohur jetën dhe veprën e të ndjerit Sahit Jashari", ka thënë kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku.

Ngushëllime familjes Jashari i kanë shprehur edhe kryetari i PDK-së, Bedri Hamza dhe ish kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se ish-krerët e UÇK-së që gjenden në paraburgim në Hagë e kanë ngushëlluar Familjen Jasharai me rastin e vdekjes së ish-komandantit të UÇK-së, Sahit Jashari. "Sot, përmes telefonatës së mëngjesit, babai me shokët e tij, që gjenden padrejtësisht në Hagë, më porositën t'jua përcjell telegramin e ngushëllimit në vijim: Të nderuar familjarë të z. Sahit Jashari. Të nderuar bashkëkombës. Me pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të luftëtarit të lirisë dhe heroit të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, Sahit Jashari. Jeta dhe vepra e tij do të mbeten përherë pjesë e historisë sonë kombëtare. Me guxim, përkushtim dhe sakrificë, ai i shërbeu atdheut në ditët më të vështira, duke lënë pas një trashëgimi të çmuar për brezat që do të vijnë. Në këto çaste të rënda, shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta për familjen Jashari, bashkëluftëtarët, miqtë dhe të gjithë ata që e njohën dhe e vlerësuan. Qoftë i përjetshëm kujtimi për luftëtarin Sahit Jasharin dhe e paharruar vepra e tij në shërbim të lirisë dhe atdheut. Me respekt, bashkëluftëtarët e z. Sahit Jasharit.

Hagë, 12 qershor 2026", ka shkruar Altin Krasniqi në "Facebook".

E pamja e familjes Jashari do të mbahet më 12 dhe 14 qershor nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Arben Hoti (RFE/RL)

KUSH ME KË? QËNDRIMET E QARTA, POR PAZARET ENDE LARG

Prishtinë, 12 qershor - Pas një viti e gjysmë paqëndrueshmëri institucionale, zgjedhjet e 7 qershorit kanë hapur një fazë të re politike në Kosovë, por jo menjëherë edhe procesin e formimit të institucioneve.

Për këtë të fundit, partitë politike sinjalizojnë se do të duhet ende kohë.

Lëvizja Vetëvendosje (LV), e cila ka dalë forca e parë politike, thotë se nuk do të ketë negociata zyrtare për koalicione të mundshme para përfundimit të numërimit edhe të votave të kandidatëve për deputetë. "Është e rëndësishme që ta dimë përfundimisht se cila është përbërja e Kuvendit të ri, e legjislaturës së 11-të", thotë për Radion Evropa e Lirë Arbërie Nagavci nga kjo parti.

Në këtë fazë, vetëm Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) shpreh qëndrim të qartë për një koalicion pa LV-në, ndërsa subjektet tjera politike lënë të hapur mundësinë e bashkëpunimit mes tyre.

Njohës të zhvillimeve politike vlerësojnë se vonesat në nisjen e negociatave mund të ndikojnë në funksionalizimin e institucioneve të reja.

Sipas tyre, ato mund të bëhen edhe para certifikimit zyrtar të rezultateve, pasi ndarja e forcave politike, në një masë të madhe, tashmë është e qartë.

Kur priten rezultatet?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se rezultatet përfundimtare pritet t'i shpallë më 26 qershor, ndërsa certifikimi i tyre planifikohet të përfundojë deri më 6 korrik.

Siç qëndrojnë të dhënat në ueb-faqen e KQZ-së aktualisht, Lëvizja Vetëvendosje ka dalë e para me 42.47 për qind të votave, e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 21.43 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 16.96 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.51 për qind dhe Lista Serbe me 6.76 për qind.

Deri në orën 12:00 të datës 12 qershor janë numëruar edhe rreth 90. 39 për qind e votave të kandidatëve për deputetë, ndërsa nuk janë numëruar ende votat e diasporës, ato me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta.

Partisë ose koalicionit qeverisës i duhen së paku 61 mandate deputetësh nga 120 sa ka Kuvendi i Kosovës.

LV: Bisedime vetëm pas pasqyrës së plotë të Kuvendit

Nga Lëvizja Vetëvendosje theksojnë se çdo diskutim zyrtar për formimin e Qeverisë së re të Kosovës duhet të presë përfundimin e numërimit të votave për deputetë, për të pasur një pasqyrë të plotë të përbërjes së Kuvendit.

Arbërie Nagavci, ish-shefe e grupit parlamentar të LV-së dhe aktualisht kandidate për deputete, nuk e përjashton mundësinë e kontakteve joformale me partitë e tjera, por thekson se negociatat serioze mund të nisin vetëm pasi të përfundojë procesi i numërimit.

Sipas saj, është e domosdoshme të dihet përbërja përfundimtare e Kuvendit, përfshirë edhe deputetët nga komunitetet joshumicë, para se të bëhet ndonjë marrëveshje politike. "Është e rëndësishme ta kemi të qartë përbërjen e legjislaturës së re, dhe më pas të vazhdohet me formimin e Qeverisë dhe, pa humbur kohë, edhe me zgjedhjen e presidentit apo presidentes", thotë Nagavci për Radion Evropa e Lirë.

Dështimi i Kuvendit për të zgjedhur presidentin e ri të shtetit në përputhje me një vendim të Gjykatës Kushtetuese çoi automatikisht në shpërndarjen e tij mesnatën e 28 prillit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja më 7 qershor.

Sistemi politik në Kosovë është i tillë që për një numër vendimesh të rëndësishme, përfshirë zgjedhjen e presidentit, kërkohet shumicë prej dy të tretash në Kuvend.

Kjo e bën të domosdoshëm bashkëpunimin ndërmjet partive dhe arritjen e marrëveshjeve politike.

Nagavci thotë se një president unifikues, që nuk është i lidhur ngushtë me partitë politike, do të ishte zgjidhje e favorshme për stabilitet institucional.

PDK: Marrëveshjet duhet të arrihen para konstituimit të Kuvendit

Partia Demokratike e Kosovës shpreh gatishmëri për bashkëpunim me subjektet e tjera politike dhe nuk vendosi vija të kuqe në raport me asnjë parti - përfshirë edhe Lëvizjen Vetëvendosje - në funksion të arritjes së një marrëveshjeje eventuale për formimin e institucioneve të reja.

Radio Evropa e Lirë nuk arriti të bjerë në kontakt me drejtuesit e kësaj partie për të marrë qëndrim të detajuar mbi mënyrën se si e shohin një marrëveshje të tillë.

Por, kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, deklaroi për mediat më 8 qershor se partia e tij është e hapur për bisedime me të gjitha subjektet politike, pa përjashtuar as LV-në, me të cilën, në të kaluarën, ka pasur dallime të theksuara politike dhe retorikë të ashpër.

"Mendoj se për të pasur institucione shpejt dhe të qëndrueshme, duhet të ketë marrëveshje politike qysh tash, ende pa filluar konstituimi i Kuvendit, formimi i Qeverisë dhe pastaj zgjedhja e presidentit", tha Hamza.

Ai shtoi se preferencë e tij do të ishte krijimi i një qeverie nga partitë që në legjislaturën e kaluar kanë qenë në opozitë.

LDK: Vonesa dëmton procesin politik

Në Lidhjen Demokratike të Kosovës thonë se janë të gatshëm për bashkëpunim dhe marrëveshje për institucionet e reja, por, sipas tyre, nisma duhet të vijë nga partia fituese, LVV.

Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, thotë se bisedimet duhet të fillojnë menjëherë dhe se nuk ka arsye të pritet certifikimi i rezultateve. "Unë e quaj arrogancë politike çdo vonesë, çdo ditë të humbur dhe çdo ditë me mungesë bashkëpunimi. Është sinjal i keq", thotë Haziri për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se të gjitha subjektet politike, përfshirë edhe LDK-

KURTI: ZGJEDHJA E PRESIDENTIT KËRKON BASHKËPUNIM ME OPOZITËN

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka folur të premten për procesin e numërimit të votave, formimin e institucioneve të reja dhe çështjen e zgjedhjes së presidentit të vendit.

Ai ka thënë se ende po pritet përmbyllja e numërimit të votave, ndërsa vetëm pas përfundimit të këtij procesi do të mund të diskutohen hapat e ardhshëm politikë. "Njëherë jemi ende duke pritur numërimin e votave. Me rastin e përmbylljes së numërimit të votave do të mund të bisedojmë për hapat e ardhshëm", ka deklaruar Kurti.

Sipas tij, është e qartë se Lëvizja Vetëvendosje dhe partnerët e saj të koalicionit kanë dalë fitues të zgjedhjeve, duke marrë rolin kryesor në themelimin e institucioneve të legjislaturës së 11-të.

Kurti u ndalë edhe te zgjedhja e presidentit, duke theksuar se ky proces kërkon bashkëpunim me opozitën, në përputhje me një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. "Për zgjedhjen e presidentit duhet bërë bashkëpunim me opozitën, pasi kërkohet që 80 deputetë të marrin pjesë në votimin e fshehtë", ka thënë ai.

Kryeministri në detyrë shtoi se partia e tij mbetet e gatshme për komunikim dhe bashkëpunim politik, duke kujtuar se gjatë mandatit qeverisës kishte bërë oferta për opozitën, të cilat, sipas tij, ishin refuzuar. "Ne kemi qenë të vullnetshëm dhe të interesuar për komunikim e bashkëpunim. Kemi propozuar takime dhe bashkëqeverisje me LDK-në, por këto iniciativa janë refuzuar", është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se nga ana e Vetëvendosjes ka pasur vazhdimisht iniciativa, konstruktivitet dhe angazhim, duke shprehur shpresën se edhe opozita do të tregojë të njëjtën qasje në procesin e konstituimit të institucioneve të reja. "Shpresojmë që kësaj radhe do të jetë ndryshe dhe se do të shohim më shumë konstruktivitet nga opozita për konstituimin e institucioneve të legjislaturës së 11-të", ka thënë Kurti.

Sipas të dhëna preliminare të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje ka dalë e para me 43.15 për qind të votave, e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 21.04 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 17.13 për qind, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.22 për qind dhe Lista Serbe me 6.42 për qind.

Teksa numërimi i votave po vazhdon, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka thënë se planifikon që të shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve më 26 qershor dhe t'i certifikojë më 6 korrik, por këto afate janë vetëm planifikime, pasi do të varet edhe nga ankesat që mund të ushtrojnë palët lidhur me procesin.

---

në, duhet ta kuptojnë se bashkëpunimi ndërpartiak nuk është vetëm çështje vullneti politik, por edhe pjesë e frymës kushtetuese. "Në momentin kur LDK-ja të ulet në tavolinë për bisedime, do të jetë e gatshme të diskutojë si për zgjedhjen e presidentit, ashtu edhe për formimin e Qeverisë si institucion", thekson Haziri.

Në zgjedhjet e 7 qershorit, LDK-ja ka garuar me Vjosa Osmanin si kandidate për presidente dhe Lumir Abdixhikun si kandidat për kryeministër.

Pas shpalljes së rezultateve të para, Osmani ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje nuk ka arsye ta refuzojë kandidaturën e saj, por, në një postim në Facebook të nesërmen, ka shkruar se emri i saj "as nuk ka qenë, as nuk është dhe as nuk do të bëhet pengesë në krijimin e institucioneve".

Aleanca: Pa LV-në në Qeveri dhe në pritje të certifikimit

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mban një qëndrim më të prerë, duke deklaruar se nuk do të hyjë në marrëveshje me Lëvizjen Vetëvendosje.

Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, thotë për Radion Evropa e Lirë se, fillimisht, duhet të përfundojë procesi i certifikimit të rezultateve, e më pas të diskutohen opsionet për formimin e institucioneve të reja. "Duhet pritur certifikimi dhe pastaj të shohim se si do të ecim më tutje", thotë ai, duke shtuar se AAK-ja preferon një koalicion të partive që deri tani kanë qenë në opozitë.

Sipas tij, LV-ja duhet të kalojë në opozitë, për shkak të "dëmeve" që i ka shkaktuar vendit.

Kritikat e AAK-së ndaj Qeverisë së LV-së kanë qenë të vazhdueshme - qoftë për stagnim ekonomik apo për prishje të marrëdhënieve me aleatët ndërkombëtarë - por ato nuk janë përfillur nga partia në pushtet.

Pa marrëveshje politike, vendi rrezikon zgjedhje të reja

Analisti dhe profesori i Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, Rrahman Paçarizi, vlerëson se nisja e bisedimeve zyrtare ndërmjet subjekteve politike për arritjen e një marrëveshjeje që do të çonte drejt konsolidimit të institucioneve të reja, nuk duhet të presë domosdoshmërisht certifikimin e rezultateve zgjedhore.

Megjithatë, ai nuk pret që bisedimet të fillojnë pa një pasqyrë më të qartë të përbërjes së re të Kuvendit, e cila do të kompletohet pas numërimit të të gjitha votave - përfshirë ato të diasporës, me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta, që në total arrijnë rreth 130 mijë. "Votat e diasporës mund ta ndryshojnë numrin e deputetëve, por jo renditjen e partive politike", thotë Paçarizi për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, partitë politike i presin këto rezultate për të bërë kalkulimet përfundimtare, veçanërisht Lëvizja Vetëvendosje si forca e parë.

Ai thotë se nëse LV-ja siguron mbi 50 deputetë, kjo do ta ndryshonte ndjeshëm balancën politike, duke i mundësuar formimin e institucioneve me komunitetet joserbe, të cilat i kanë dhjetë ulëse në Kuvend, pa vështirësi të mëdha. "Do të shohim se sa serioze është LV-ja për bashkëpunim kur t'i qaset formimit të Qeverisë. Nëse shkon pa koalicion dhe pa marrëveshje në pako për kryetarin e Kuvendit, kryeministrin dhe presidentin, është shumë e vështirë të sigurohen 80 vota për presidentin", thekson ai.

Nëse presidenti nuk zgjidhet, Paçarizi paralajmëron mundësinë e zgjedhjeve të reja, ndërsa garën politike mes partive e sheh të orientuar drejt postit të kryeministrit.

Ai vlerëson se vendimet e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese nuk lënë hapësirë për zvarritje të qëllimshme të proceseve politike, por nuk e përjashton mundësinë e shfrytëzimit të vakumeve procedurale për kalkulime politike. "Çështje si rendi i zgjedhjes së institucioneve mund të keqpërdoren. Aktualisht diskutohet nëse duhet të zgjidhet Qeveria apo presidenti pas konstituimit të Kuvendit. Por, çdo veprim pa një marrëveshje në pako për pozitat kryesore, mund ta çojë vendin në zgjedhje", thotë Paçarizi.

"Kauza fiktive" si pretekst ligjor për zvarritje

Në rast se partitë politike përplasen rreth rendit të formimit të institucioneve - nëse fillimisht duhet të zgjidhet Qeveria apo presidenti - debati i tillë mund të përdoret si "kauzë fiktive" për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, vlerëson Vullnet Bugaqku, ekspert i çështjeve juridike në Institutin Demokratik të Kosovës.

Sipas tij, një qasje e tillë nuk do të kishte bazë reale juridike dhe do të shërbente kryesisht për zvarritjen e proceseve dhe fitimin e kohës nga subjektet politike. "Për të pasur një rast kushtetues, duhet të ketë një vendim ose shkelje procedurale në Kuvend. Nuk besoj se Gjykata do ta pranonte si pyetje se a duhet të zgjidhet më parë Qeveria apo presidenti", thotë Bugaqku për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se hapësirë për interpretim mund të krijohet vetëm nëse subjektet politike dështojnë të përmbushin afatin për konstituimin e Kuvendit, i cili duhet të përfundojë brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve.

Në një rast të tillë, sipas tij, mund të lindin situata që kërkojnë sqarim institucional.

E, për të shmangur një cikël të ri bllokadash institucionale dhe pasojash politike, ai thotë se zgjidhja më e shpejtë dhe më funksionale mbetet arritja e një marrëveshjeje politike ndërmjet partive.

Zgjedhjet e 7 qershorit ishin të tretat brenda më pak se një viti e gjysmë, pas zgjedhjeve të rregullta të 9 shkurtit 2025 dhe një procesi tjetër të parakohshëm më 28 dhjetor.

Zgjedhjet e para nuk prodhuan qeveri funksionale, ndërsa ato të dytat, edhe pse i siguruan Lëvizjes Vetëvendosje mbi 51 për qind të votave, nuk arritën të çojnë në marrëveshje për zgjedhjen e presidentit.

A MUND TË MBYLLË KPM-ja EMISIONE TELEVIZIVE?

Deklarimi i një anëtareje të Komisionit të Pavarur të Mediave se do të propozojë mbylljen e një emisioni televiziv, nxiti reagime dhe debate në Kosovë. Reagimet u shoqëruan me pikëpyetje nëse një gjë e tillë është kompetencë e këtij organi që rregullon dhe menaxhon mediat. Por, a mundet KPM-ja ta bëjë këtë, sipas ekspertëve të fushës?

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Një paralajmërim këtë javë i një prej drejtuesve të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) në Kosovë për mbyllje emisionesh televizive nxiti reagime të ashpra dhe ngriti pikëpyetje se a po përpiqet t'i tejkalojë kompetencat e veta ky organ i pavarur për rregullimin dhe menaxhimin e mediave në vend.

Nënkryetarja e KPM-së, Drita Morina - e cila u bë anëtare e komisionit vetëm dy muaj më parë - paralajmëroi gjatë një mbledhjeje të komisionit më 10 qershor se në mbledhjen e radhës do të propozonte mbylljen e emisionit "Debat Plus" në RTV Dukagjini, nëse "shkeljet përsëriten", duke iu referuar deklaratave fyese të pjesëmarrësve në debat.

Ekspertët ligjorë vlerësojnë se një hap i tillë shkon përtej kompetencave të KPM-së.

Çka është KPM-ja dhe cilat janë kompetencat e saj?

Sipas ligjit, KPM-ja është organ i pavarur përgjegjës për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Kosovë.

Në bazë të ligjit, KPM-ja licencon transmetuesit publikë e privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuele.

Misioni i tij, ndër të tjera, është edhe ta mbrojë lirinë e shprehjes dhe shumëllojshmërinë e mendimit.

Juristja e të drejtës së mediave, Flutura Kusari, e cila e vëzhgoi mbledhjen e KPM-së, thotë për Radion Evropa e Lirë (REL) se KPM-ja mund të konstatojë shkelje të Kodit të Etikës dhe të shqiptojë masa të parapara me ligj, por jo të urdhërojë mbylljen e një emisioni televiziv, si masë të veçantë.

"Roli i KPM-së është të vendosë nëse media ka shkelur etikën dhe këtë mund ta bëjë duke u fokusuar ekskluzivisht në aspekte procedurale", thekson ajo.

Mbyllja e një emisioni debatues mbi çështje politike dhe aktuale nga KPM-ja bie ndesh me vetë frymën e Kodit të Etikës së komisionit, thotë ish-drejtuesi i KPM-së, Jeton Mehmeti, i cili thekson se në nenin 2 të Kodit garantohet liria e shprehjes. "Një ndërhyrje e tillë mund të justifikohet vetëm kur një medium, në mënyrë të qëllimshme, transmeton përmbajtje që cenojnë rendin kushtetues, sigurinë publike ose interesat themelore të Republikës së Kosovës", thotë Mehmeti për Radion Evropa e Lirë.

Në të kaluarën, duke u thirrur në cenim të sigurisë kombëtare dhe shkelje të rregullores së saj, KPM-ja kishte urdhëruar largimin e kanaleve sportive të rrjetit televiziv serb, Arena, që transmetoheshin nga disa platforma kabllore.

Çfarë ndodhi në mbledhjen e KPM-së?

Gjatë mbledhjes më 10 qershor, KPM-ja njoftoi se shqyrtoi rastet e iniciuara nga vetë komisioni lidhur me shkeljet e vërejtura gjatë mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele gjatë heshtjes zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit.

Disa televizione, përfshirë RTV Dukagjini, morën vërejtje me shkrim nga komisioni, pasi kishin publikuar deklarata të politikanëve gjatë heshtjes zgjedhore.

Emisioni "Debat Plus" nuk ishte temë specifike e mbledhjes dhe as nuk u përmend në njoftimin e KPM-së.

Por, Morina e përmendi atë dhe tha se gjatë kohës që ajo është anëtare, "rastet e tilla po përsëriten nga emisioni i njëjtë", duke shtuar se do të kërkonte "mbylljen e tij deri në ndalimin e emetimit të emisionit të tillë".

Ajo po iu referohej deklaratave të përdorura gjatë debateve politike në "Debat Plus" nga pjesëmarrësit, dhe u arsyetua me ankesën e bërë nga Artane Rizvanolli, ministrja në detyrë e Ekonomisë.

Rizvanolli e ka akuzuar Uran Ismailin e Partisë Demokratike të Kosovës se ka bërë shpifje dhe fyerje gjatë një edicioni të "Debat Plusit".

Pasojat nga masat e mundshme

KPM-ja nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it lidhur me paralajmërimin e Morinës dhe nëse një kërkesë të tillë do të shqyrtohej në mbledhjen e radhës dhe mbi çfarë arsyesh.

Kusari thekson për REL se "KPM-ja po i tejkalon kompetencat e veta ligjore duke vendosur se çfarë është shpifje, çfarë është fyerje apo ofendim dhe është duke e luajtur rolin e gjykatës".

Ajo e kritikon përbërjen e re të KPM-së - e zgjedhur në prill nga Kuvendi i Kosovës - e cila, sipas saj, po bën presion politik në media me qëllim që ato "të mos e kritikojnë Lëvizjen Vetëvendosje dhe kryeministrin [në detyrë, Albin] Kurti apo ministrat e Qeverisë së tij".

Sipas ish-kreut të KPM-së, Jeton Mehmeti, në raste si ky, çdo pretendim për shkelje të Kodit parashikon një sërë hapash dhe masash paraprake, përpara se të mendohet ndonjë sanksion. "Pezullimi i një emisioni, pezullimi i të gjithë programit të një televizioni apo revokimi i licencës përbëjnë masat më të rënda që mund të ndërmerren ndaj një transmetuesi. Këto masa kanë pasoja të pakthyeshme financiare e profesionale për mediumin dhe përdoren vetëm në rrethana jashtëzakonisht serioze", vlerëson Mehmeti.

Ai beson se "nuk ka asnjë rrethanë" që do ta arsyetonte shqyrtimin e mbylljes së emisionit në fjalë nga KPM-ja në mbledhjen e saj të ardhshme.

Kusari, ndërkaq, nënvizon se kompetencë e KPM-së është të shikojë nëse në emisione debatuese respektohet e drejta e përgjigjes, nëse i jepet hapësirë palëve të përfolura, e kështu me radhë.

Gjithashtu, sipas saj, në debatet e transmetuara drejtpërdrejt, KPM-ja duhet t'i zbatojë standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke mos mbajtur përgjegjës mediat për fjalët e shprehura nga palët e treta, por vetë folësit.

Mbi 22 mijë foshnje të lindura në Kosovë në vitin 2025

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat vjetore për lindjet për vitin 2025.

Në vitin 2025, janë regjistruar gjithsej 32 955 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës).

Prej këtyre lindjeve të regjistruara, vetëm në Kosovë janë lindur 22 045 foshnje, nga të cilat 11 398 ishin meshkuj (ose 51,7%) dhe 10 647 ishin femra (ose 48,3%).

Sipas dispozitave ligjore mbi udhëheqjen e regjistrave themeltarë për Lindjet, rastet regjistrohen në mënyrë obligative në regjistrat e lartëcekur, në vendin ku ka ndodhur ngjarja, pa marrë parasysh se personat me të cilët lidhet ngjarja, vendbanimin e përhershëm e kanë në atë vend ose në ndonjë vend tjetër. ASK-ja do të vazhdojë me grumbullimin e të dhënave përmes pyetësorëve të veçantë statistikorë, për Lindjet DEM-1, gjatë këtij viti kalendarik, sikurse deri më tani. Grumbullimi i të dhënave vazhdon të bëhet çdo muaj dhe do të shërbejë për krijimin e bazës së të dhënave, si dhe krahasimin me të dhënat administrative.

Me rastin e shfrytëzimit të këtyre informatave të publikuara, ASK-ja do t'i pranojë sugjerimet dhe propozimet që do të ndihmojnë t'i begatojë përmbajtjet e këtyre raporteve në të ardhmen.

LIDERËT POLITIKË KUJTOJNË SAKRIFICËN PËR LIRI NË 27-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË KOSOVËS

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 12 qershor - Në 27-vjetorin e Çlirimit të Kosovës, ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu së bashku me kryeministrin në detyrë Albin Kurti, kanë bërë homazhe të premten në Prekaz.

Haxhiu ka thënë se nuk ka 12 qershor pa marsin e vitit 1998. "Nuk ka liri pa qëndresën e Adem Jasharit, të Hamzës, të Shabanit dhe të mbi pesëdhjetë anëtarëve të familjes Jashari, që ranë në mbrojtje të atdheut. Prandaj, me nderim dhe përulësi, bëmë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", vendin ku u shkruan faqet më të lavdishme të historisë sonë kombëtare. Familja Jashari nuk mbrojti vetëm pragun e shtëpisë së tyre. Mbrojti tokën e të parëve, këtë tokë që ishte, është dhe mbetet e shqiptarëve. Mbrojtën idenë se ky popull nuk mposhtet. Sakrifica e familjes Jashari u bë themeli mbi të cilin u ngrit Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe mbi të cilin qëndron sot Republika jonë e lirë", ka thënë Haxhiu, duke shtuar se liria që e gëzojmë është amaneti i tyre.

"Ne, si institucione e si qytetarë, kemi për detyrë ta ruajmë e ta ndërtojmë çdo ditë Kosovën për të cilën ata dhanë gjithçka. Lavdi Komandantit Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit!", është shprehur Haxhiu.

Me rastin e 27-vjetorit të Çlirimit të Kosovës, kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka shprehur nderime për dëshmorët, martirët, invalidët dhe veteranët e UÇK-së që sakrifikuan gjithçka për atdheun. "Disa ranë për Kosovën, disa jetuan për të, por të gjithë janë pjesë e kujtesës sonë. Kosova u çlirua me një luftë të drejtë dhe kjo e vërtetë, nga lufta për liri deri te gjykimi në Hagë, do të mbetet e pandryshuar. Liri për të gjithë çlirimtarët! Gëzuar Ditën e Çlirimit, Kosovë!", ka shkruar Hamza në "Facebook".

Edhe ish-kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka uruar qytetarët e Kosovës për Ditën e Çlirimit.

Ai ka thënë se fitorja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe hyrja e forcave tokësore të NATO-s shënojnë ngjarjen më kulmore në historinë tonë të re. "Sot, me nderim e përulje të përjetshme, kujtojmë trimat e

UÇK-së nga të gjitha anët e Kosovës, sakrificën e dëshmorëve dhe martirëve, dhe dhimbjen e familjeve tona që dhanë më të shtrenjtit për lirinë e vendit. Mirënjohje e thellë për aleatët tanë, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe për NATO-n, që qëndruan përkrah popullit të Kosovës në ditët më vendimtare të historisë sonë. Zoti e bekoftë Kosovën, mbarë kombin tonë dhe miqtë e saj!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ish-presidentja Vjosa Osmani ka thënë se 12 Qershori është dita kur lotët e dhimbjes nisën t'i lëshojnë vend shpresës. "Dita kur Kosova filloi të marrë frymë e lirë. Dita kur ëndrra e shumë brezave për liri u bë realitet. Kjo është dita kur mbi tokën e djegur e të stërvuajtur të Kosovës zbarkoi shpresa. Dhjetëra mijëra ushtarakë të shteteve të NATO-s hynë në Kosovë, duke sjellë dritë në vend të errësirës së pafund që përjetonte populli ynë prej shekujsh", ka shkruar ajo në "Facebook".

Osmani ka thënë se sot, me dhimbje e krenari, kujtojnë bijat dhe bijtë më të mirë të këtij vendi, dëshmorët e UÇK-së të prirë nga Kryekomandanti Adem Jashari, si dhe martirët e lirisë që dhanë jetën që ne të jetojmë të lirë. "Kujtojmë familjet që sakrifikuan gjithçka, të mbijetuarit që bartën plagët e luftës dhe të gjithë ata që nuk u dorëzuan kurrë përballë padrejtësisë. Në këtë ditë të shenjtë shprehim mirënjohjen e pafund për vizionin e Atit Themeltar të Republikës sonë, Presidentit Rugova, i cili në kohët më të rënda të historisë sonë diti të ndërtojë aleanca që na u gjendën pranë në ditët më të vështira. Mirënjohja e popullit te Kosovës për aleatët e lirisë do të mbetet e përjetshme. Kosova do të vazhdojë të ecë përpara e lirë, e pavarur, sovrane, e përjetshme! Sepse përjetësinë ia dhanë dëshmorët dhe martirët e lirisë, vizioni i Presidentit Rugova dhe aleatët që na qëndruan në krah", ka shkruar Osmani.

MAVRAJ NË 27-VJETORIN E ÇLIRIMIT: PA NATO-n nuk do të çliroheshim, pa UÇK-në NUK DO TA KISHIM NATO-n NË KOSOVË

Prishtinë, 12 qershor - Publicisti dhe profesori universitar, Muhamet Mavraj, ka uruar 27-vjetorin e Çlirimit të Kosovës, duke theksuar se kjo ditë sjell në kujtesë një të vërtetë të pamohueshme: "Pa NATO-n nuk do të çliroheshim shpejt dhe pa UÇK-në nuk do ta kishim NATO-n këtu".

Në urimin e tij, Mavraj ka shprehur nderime të pakufishme për dëshmorët e kombit, ndërsa nuk i ka harruar as ish-krerët e UÇK-së që po mbahen në paraburgim në Hagë, për të cilët ka kërkuar liri. "Është një e vërtetë që nuk ndahet dysh, një fjali që nuk ndahet dysh, e thënë që atëherë, këtu e 27 vjet, dhe nuk kam tjetër për të thënë: Pa NATO-n nuk do te çliroheshim shpejt dhe pa UÇK-në nuk do të kishim këtu NATO. As në ëndrrat më të mira! Nderime pa kufi për dëshmorët tanë! Liri për strategët e lirisë që ende janë në Hagë! Poshtë antiamerikanët!", ka shkruar Mavraj.

Zgjerimi i bashkëpunimit ekonomik Kosovë - Shqipëri, në qendër të takimit Krasniqi - Ekonomi

Prishtinë, 12 qershor - Kryetari i Bordit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, Skender Krasniqi, ka takuar kryetaren e Komisionit Parlamentar për Ekonominë, Punësimin dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, Milva Ekonomi.
Gjatë takimit u diskutua për rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.
Palët shkëmbyen ide dhe nisma konkrete për nxitjen e investimeve, lehtësimin e të bërit biznes dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet sipërmarrjeve, si një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit ekonomik të të dy vendeve.
Në takim u vlerësua se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe komunitetit të biznesit mbetet çelësi për krijimin e më shumë mundësive, zgjerimin e tregut dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik në dobi të qytetarëve të të dyja vendeve.

TURIZMI GJENEROI MBI 248 MILIONË EURO NDIKIM EKONOMIK GJATË VITIT 2025

Qendresa RAMA

Prishtinë, 12 qershor - Unioni i Turizmit të Kosovës mirëpret publikimin e raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për Statistikat e Hotelerisë dhe Turizmit për vitin 2025, i cili konfirmon vazhdimin e trendit pozitiv të zhvillimit të sektorit të turizmit në vend.
Sipas njoftimit të Policisë thuhet se sipas të dhënave zyrtare të ASK-së, gjatë vitit 2025 në Kosovë janë regjistruar gjithsej 762,836 vizitorë, prej të cilëve 39.3% ishin vizitorë vendorë dhe 60.7% vizitorë ndërkombëtarë. "Numri i përgjithshëm i net-qëndrimeve arriti në 1,653,390, duke shënuar rritje të vazhdueshme krahasuar me vitin paraprak. Duke u bazuar në të dhënat e net-qëndrimeve dhe në një vlerësim mesatar prej 150 eurosh shpenzim për vizitor për çdo 24 orë qëndrimi në Kosovë, rezulton se gjatë vitit 2025 sektori i turizmit ka gjeneruar një ndikim ekonomik të vlerësuar prej rreth 248,008,500 euro", thuhet në njoftim.

Tutje bëhet me dije se kjo shumë përfaqëson kontributin e drejtpërdrejtë të vizitorëve në ekonominë e vendit përmes shpenzimeve në akomodim, gastronomi, transport, tregti, aktivitete kulturore, rekreative dhe shërbime të tjera turistike. "Këto rezultate dëshmojnë se turizmi po shndërrohet në një nga sektorët më dinamikë dhe me potencialin më të madh për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Unioni i Turizmit të Kosovës vlerëson se këto rezultate janë dëshmi e punës së përbashkët të sektorit privat, organizatave profesionale të Turizmit dhe institucioneve publike", thuhet në njoftim.
Po ashtu siç thuhet në njoftim rritja e numrit të vizitorëve dhe e ndikimit ekonomik të turizmit duhet të shërbejë si motiv shtesë për investime të reja në infrastrukturën turistike, promovimin ndërkombëtar të Kosovës, zhvillimin e produkteve turistike dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve. "Andaj, Unioni i Turizmit të Kosovës i bën thirrje Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, si dhe të gjitha institucioneve relevante në nivel qendror dhe lokal, që të rrisin angazhimin dhe mbështetjen për promovimin dhe zhvillimin e mëtejmë të industrisë së turizmit, duke e trajtuar atë si një sektor strategjik për zhvillimin ekonomik të vendit", bëhet e ditur në njoftim.
Siç thuhet në njoftim UTK mbetet e përkushtuar që të kontribuojë në këtë drejtim përmes bashkëpunimit të ngushtë me institucionet publike, sektorin privat, partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, me qëllim të fuqizimit të mëtejmë të industrisë së turizmit dhe rritjes së konkurrueshmërisë së Kosovës si destinacion turistik.
Turizmi nuk është vetëm promovim i imazhit të Kosovës, por edhe një sektor strategjik që krijon vende pune, gjeneron të ardhura dhe kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

NË TIRANË MBAHET KONFERENCA 'AUDITUES TË PËRGATITUR PËR TË ARDHMEN', PJESË E SAJ EDHE ZKA-ja

Prishtinë, 12 qershor - Auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), Albana Sahiti dhe Drilon Osmani më 9 dhe 10 qershor 2026 morën pjesë në Konferencën VII Young EUROSAI (YES Conference), organizuar në Tiranë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë.
Konferenca me temën "Auditues të përgatitur për të ardhmen: Nxitës të ndryshimit në një botë të qëndrueshme dhe digjitale", mblodhi mbi 65 auditorë të rinj nga 32 Institucione Supreme të Auditimit të vendeve anëtare të EUROSAI-t.
Përfaqësuesit e ZKA-së përmes prezantimit shpalosën përvojën e ZKA-së në përshtatjen me zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin si dhe angazhimin e saj për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe përdorimin e teknologjisë në funksion të rritjes së cilësisë dhe ndikimit të auditimit publik.
Pjesëmarrësit shkëmbyen praktikat më të mira në fushën e auditimit publik si dhe trajtuan tema që lidhen me transformimin digjital, përdorimin e teknologjive të reja në auditim, inteligjencën artificiale, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe qëndrueshmërinë institucionale.

KRU "Prishtina" vazhdon angazhimin për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe zgjerimin e rrjetit në Podujevë

Prishtinë, 12 qershor - Me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe investimin e KRU "Prishtina", mbi 2.2 milionë euro do të investohen për të siguruar furnizim më të rregullt me ujë të pijshëm dhe për të zgjeruar rrjetin e ujësjellësit në qytet dhe fshatra.
Ky projekt do të përfitojë rreth 27,500 banorë, duke përfshirë Podujevën dhe fshatrat: Llapashticë, Katunishtë, Gllamnik, Dumosh, Sfeçël, Livadicë, Ballovc, Lladovc dhe Surkish.
Investimi parasheh ndërtimin dhe zgjerimin e linjave të reja të ujësjellësit, përmirësimin e presionit në rrjet, zvogëlimin e humbjeve teknike dhe rritjen e cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët.
KRU "Prishtina" mbetet e përkushtuar për të sjellë shërbime më cilësore dhe infrastrukturë më të avancuar për të gjithë konsumatorët.

MEDIA AMERIKANE: SHBA PLANIFIKON TË TËRHEQË NJË TË TRETËN E AVIONËVE LUFTARAKË NGA EVROPA

Vendimi pritet të kufizojë aftësinë e NATO-s për të kryer sulme me rreze të gjatë veprimi dhe operacione mbikëqyrjeje.

Ai u është komunikuar aleatëve në fillim të qershorit përmes një dokumenti zyrtar, pjesë të të cilit janë parë nga "The New York Times". Zyrtarët evropianë folën në kushte anonimiteti për shkak të ndjeshmërisë së planeve ushtarake.

Pentagoni refuzoi të komentojë shifrat konkrete të dokumentit, duke iu referuar një deklarate të Komandës Evropiane të ShBA-së, e cila javën e kaluar njoftoi në terma të përgjithshëm synimin për të reduktuar angazhimet në Evropë.

Detajet, disa prej të cilave u raportuan fillimisht nga media gjermane "Die Welt", japin pamjen më të qartë deri më tani për shkallën e reduktimit të angazhimit të administratës së presidentit Donald Trump ndaj NATO-s. Aleanca ushtarake, e krijuar pas Luftës së Dytë Botërore, konsiderohet ende nga vendet evropiane si thelbësore për frenimin e Rusisë.

Pentagoni nuk ka bërë publike ende afatet e zbatimit të planit, por zyrtarë amerikanë kanë lënë të kuptohet se ndryshimet do të hyjnë në fuqi shumë shpejt, më herët sesa kishin parashikuar aleatët evropianë.

Një reduktim i tillë do të ndikonte në aftësinë e NATO-s për të monitoruar lëvizjet e nëndetëseve ruse ose për të lëshuar raketa me rreze të gjatë veprimi, si Tomahawk, thellë në territorin rus. Ekspertët vlerësojnë se, edhe pse vendet evropiane kanë kapacitete të ngjashme raketore, efekti parandalues është më i madh kur këto sisteme kontrollohen nga ShBA-ja.

Presidenti Trump ka kritikuar prej vitesh barrën që, sipas tij, ShBA mban brenda NATO-s. Ai ka kërkuar vazhdimisht që Evropa të investojë më shumë në mbrojtjen e saj dhe madje ka kërcënuar me largim nga aleanca.

Evropa vazhdon të përballet me vështirësi në koordinimin e përpjekjeve të saj ushtarake. Gjermania konfirmoi së fundmi tërheqjen nga një projekt i përbashkët me Francën dhe Spanjën për ndërtimin e një avioni të ri luftarak.

Për disa politikanë evropianë, çështja kryesore nuk është më numri i mjeteve ushtarake

amerikane në Evropë, por nëse administrata Trump do të ishte e gatshme t'i përdorte ato në rast konflikti.

Plani i reduktimit vjen në një moment të tensionuar për Evropën.

Detajet e planit u komunikuan në mënyrë private ndërsa zyrtarët më të lartë amerikanë të mbrojtjes po flisnin publikisht për nevojën e ridislokimit të forcave drejt rajonit Indo-Paqësor.

Gjenerali Alexus G. Grynkewich, komandanti i Komandës Evropiane të ShBA-së dhe komandanti më i lartë ushtarak i NATO-s, deklaroi në fillim të qershorit se "ka pasur një bashkëvarësi jo të shëndetshme të modelit të forcave të NATO-s nga forcat amerikane".

Ai shtoi se presidenti Trump, sekretari i Mbrojtjes Pete Hegseth dhe zyrtarë të tjerë kanë qenë të qartë se kjo situatë duhet të ndryshojë dhe do të ndryshojë, pasi mundësia e konflikteve të njëkohshme në disa rajone të botës e kërkon këtë.

BOTËRORI - MIRË SE VINI NË SPEKTAKLIN MË TË MADH PAS BIG BENGUT

Një Kampionat Botëror i florinjtë

Lamine Yamal dhe Kylian Mbappé, Gianni Infantino dhe Donald Trump. Mirë se vini në spektaklin më të madh pas Big Bengut. Para, pushtet, pushtet dhe para. Nesër do të nisë Botërori, një aktivitet sportiv më e pasur se kurrë. Sigurisht, do të jetë e para me 48 skuadra, në emër të globalizmit që është shenja dalluese e kësaj presidence të FIFA-s. Por nuk është vetëm kaq. Industria e futbollit, e aftë të rimëkëmbet edhe pas një pandemie, është në rritje të vazhdueshme: më shumë publik, më shumë sponsorë, më shumë investitorë. Kupa e Botës, e organizuar nga SHBA-ja, pra nga ekonomia që, mes krizës së naftës dhe kërcënimeve kineze, vazhdon të tërheqë planetin, me Kanadanë dhe Meksikën në krah, është manifestimi i saj.

A e dini sa është vlera e tregut e përllogaritur e 1248 lojtarëve të listuar në 48 kombëtaret pjesëmarrëse? Plot 13 miliardë euro, sipas vlerësimeve të Football Benchmark dhe Transfermarkt. Vlera e dhjetë skuadrave të para është rritur me një miliard krahasuar me edicionin e vitit 2022. Është "player trading", bukuria. Yjet e futbollit botëror, me talentin e tyre dhe ndjekjen masive të shtuar nga mediat e reja që rrëzojnë çdo barrierë, janë asete tepër të çmuara, të afta të shkëlqejnë edhe më shumë falë "mungesës" së tyre.

Talentet dhe Botërori

Merrni Lamine Yamalin: në moshën 18-vjeçare ai ka fituar tashmë një Kampionat Europian me Spanjën dhe dy tituj të La Ligës me Barcelonën. Videot e tij si adoleshent qarkullojnë në rrjetet sociale, aq sa në TikTok ka më shumë ndjekës se kushdo tjetër (44 milionë). Ai është neo-futbollisti në shprehjen e tij më të plotë dhe vlera e tij teorike e tregut tashmë ka shpërthyer në 292 milionë euro sipas Football Benchmark, pothuajse e dyfishuar krahasuar me një vit më parë, kur klubi blaugrana e lidhi me kontratë deri në vitin 2031 me një klauzolë largimi prej një miliard eurosh.

Pas tij vjen Mbappé, alter egoja e Clásico-s: sulmuesi i Real Madridit vlen 221 milionë euro dhe e çon Francën në vendin e parë mes kombëtareve, me një kuotë prej 1.6 miliardë eurosh, pikërisht përpara Spanjës (1.5 miliardë). Dikur protagonistët e Clásico-s ishin

Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo, në Kupën e tyre të fundit të Botës, e destinuar të vinte në skenë kalimin e stafetës së brezave. Nëse futbolli, në këtë shekull, është shndërruar në një biznes pa kufij gjeografikë, merita u takon edhe atyre, të cilët, pasi e bënë të madh Kampionatin Europian të klubeve, u nisën në kërkim të territoreve të reja, duke përputhur ambiciet ekspansioniste të këtij sporti mes Amerikës dhe Lindjes së Mesme.

Përparimi i parasë ka ecur paralelisht me një polarizim gjithnjë e më të theksuar. Pesë kombëtaret me vlerën më të lartë të tregut (Franca, Spanja, Anglia, Gjermania dhe Portugalia) arrijnë në 6.5 miliardë euro dhe përfaqësojnë gjysmën e vlerës së përgjithshme të të 48 pjesëmarrëseve.

Pesë lojtarët më të vlefshëm (Lamine Yamal, Mbappé, Haaland, Bellingham dhe Olise) vlejnë sa 8% të totalit prej 1248 futbollistësh të pranishëm. Nga ana tjetër, Kupa e Botës është e bukur edhe sepse është e larmishme: Jordania dhe Katari vlejnë vetëm 19 milionë. Këto vlerësime pasqyrojnë, ndoshta edhe tepër, duke parë borxhet e disa klubeve, rritjen e vazhdueshme të faturimeve. FIFA, ashtu si UEFA, është prej kohësh një aktor kryesor në betejën me mbajtësit e të drejtave për të siguruar pjesët e tregut. Asnjë ngjarje sportive nuk mund të krahasohet me xhiron e biznesit të Kupës së Botës në futboll. Edicioni i këtij viti, duke shfrytëzuar formatin gjigant dhe vitrinën amerikane, do të arrijë në 10 miliardë dollarë. Lojërat Olimpike të Parisit arkëtuan gjysmën e kësaj shume.

Biznesi

Rritja krahasuar me Botërorët e mëparshëm është mbresëlënëse: 2.3 miliardë në 2006; 3.7 në 2010; 4.8 në 2014; 5.4 në 2018; 6.3 në 2022. Të gjitha zërat po rriten, sidomos biletaria: parashikohet të trefishohen të ardhurat brenda katër viteve, në kuotën e 3 miliardëve (përfshirë mikpritjen). Polemikat për çmimet e çmendura të biletave? FIFA nuk shqetësohet. Kostot organizative janë vlerësuar në 3.8 miliardë, përfshirë 871 milionë dollarë të destinuara për kombëtaret kualifikuese në formë shpërblimesh dhe rimbursimi shpenzimesh. Kjo do të thotë se turneu duhet të gjenerojë për Zyrihun një fitim prej të paktën 6 miliardë dollarësh. Prej tyre, 2.7 miliardë do të shpërndahen në katërvjeçarin e ardhshëm te 211 federatat e lidhura dhe te konfederatat kontinentale. Të gjithë të lumtur dhe të kënaqur. / gazzetta dello sport – bota.al

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

ADEMI NË CEREMONINË HAPËSE TË KUPËS SË BOTËS: NJË DITË EDHE KOSOVA DO TA SYNOJË MAJËN E FUTBOLLIT

Mexico City, 12 qershor - Presidenti i Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka marrë pjesë në ceremoninë hapëse të Kupës së Botës, ku është prezantuar trofeu më i lakmuar në futbollin botëror. Me këtë rast, Ademi ka theksuar rëndësinë dhe simbolikën e trofeut, duke kujtuar se ai kishte qëndruar edhe në Kosovë gjatë turit të tij botëror, duke u dhënë tifozëve kosovarë mundësinë që ta shihnin nga afër.

"Ky është trofeu që nga sot qëndron këtu, ndërsa pas 39 ditësh garë të fortë dhe përplot emocione do t'i dorëzohet kampionit të botës. Ky trofe ka qenë edhe në Kosovë gjatë turit të saj nëpër botë, duke u dhënë tifozëve tanë mundësinë ta shohin nga afër, gjë që pa dyshim ishte një moment i veçantë për futbollin tonë", ka deklaruar Ademi.

Ai ka shprehur gjithashtu shpresën që Kosova, përmes punës së vazhdueshme dhe zhvillimit të futbollit, një ditë të bëhet pjesë e ngjarjeve më të mëdha ndërkombëtare. "Le të shpresojmë dhe brez pas brezi të punojmë me përkushtim dhe vizion, që të jemi pjesë e ngjarjeve të tilla të mëdha dhe një ditë këtë kupë ta meritojmë dhe ta fitojmë. Futbolli është sporti ku ëndrrat bëhen realitet", ka shtuar ai.

Pjesëmarrja e kreut të FFK-së në këtë ceremoni konsiderohet një tjetër moment i rëndësishëm për përfaqësimin e futbollit kosovar në arenën ndërkombëtare.

JOSE MOURINHO ZYRTARIZOHET SI TRAJNER I RI I REAL MADRIDIT

Madrid, 12 qershor - Real Madridi ka konfirmuar zyrtarisht rikthimin e Jose Mourinhos në stolin e skuadrës. "Bordi i drejtorëve i Real Madridit, i kryesuar nga Florentino Perez, ka vendosur të emërojë Jose Mourinhon trajner të ekipit të parë për tre sezonet e ardhshme, deri më 30 qershor 2029. Jose Mourinho do t'i bashkohet Real Madridit më 13 korrik, ditën kur do të nisë faza përgatitore për sezonin e ri", ka njoftuar Real Madridi.

Ky do të jetë rikthimi i madh i teknikut portugez në "Santiago Bernabeu" pas më shumë se një dekade. Mourinho ka drejtuar Real Madridin nga viti 2010 deri në vitin 2013, periudhë gjatë së cilës ka fituar titullin e La Ligës, Kupën e Mbretit dhe Superkupën e Spanjës. Gjatë mandatit të tij të parë, ai kishte ndërtuar një skuadër konkurruese që i pati dhënë fund dominimit të Barcelonës së Pep Guardiolës në futbollin spanjoll.

Sezoni 2011/12 mbetet një nga më të suksesshmit në historinë e klubit, pasi Real Madridi kishte fituar kampionatin me 100 pikë dhe 121 gola të shënuar. Rikthimi i Mourinhos vjen pas një periudhe zhgënjyese për madrilenët, të cilët nuk kanë arritur të fitojnë trofe madhorë në dy sezonet e fundit. Presidenti Florentino Perez e ka konsideruar portugezin si figurën ideale për të rikthyer mentalitetin fitues dhe disiplinën konkurruese brenda skuadrës. Tashmë vëmendja do të zhvendoset te afati kalimtar i verës, ku pritet që Mourinho të ketë ndikim të madh në ndërtimin e skuadrës për sezonin 2026/27.

RONALDO: SPANJA DHE FRANCA, FAVORITE PËR KUPËN E BOTËS

Mexico City, 12 qershor - Legjenda braziliane e futbollit, Ronaldo Nazario, ka thënë se Spanja dhe Franca janë dy kombëtaret që nisen me më shumë gjasa për të triumfuar në Kupën e Botës 2026. Dy herë kampioni i botës, i njohur si "Fenomeni", ka dhënë vlerësimin e tij gjatë ceremonisë së hapjes së Botërorit në stadiumin legjendar "Azteca" të Meksikës, ku ishte i ftuar së bashku me shumë ish-kampionë të tjerë të botës. "Nëse ka dy ekipe që i shoh si favoritë, ato janë Spanja dhe Franca. Ato janë mbi ekipet e tjera, megjithëse ka kombëtare për të cilat duhet të jesh gjithmonë i kujdesshëm", ka thënë Ronaldo.

Komentet e tij kanë ardhur në të njëjtën ditë kur FIFA ka publikuar renditjen e saj më të fundit, ku Argjentina është rikthyer në vendin e parë.

Kampionët e botës kryesojnë renditjen, ndërsa Spanja e Luis de la Fuentes pozicionohet e dyta. Franca renditet në vendin e tretë, duke konfirmuar statusin e saj si një nga pretendentet kryesore për trofeun.

Pas tyre vijnë Anglia, Portugalia dhe Brazili, ndërsa Maroku ka shkruar histori duke u ngjitur për herë të parë në vendin e shtatë të renditjes. Kjo renditje ka rëndësi të veçantë gjatë Kupës së Botës, pasi përdoret si kriter përcaktues në rastet kur dy ose më shumë kombëtare përfundojnë me pikë të barabarta në fazën e grupeve, si dhe për të përcaktuar ekipet më të mira që avancojnë nga vendi i tretë. Pavarësisht se Argjentina mban vendin e parë në renditjen e FIFA-s, për Ronaldon dy favoritët kryesorë për triumfin në Botërorin 2026 mbeten Spanja dhe Franca.

GJASHTË NDRYSHIMET QË RIFORMËSOJNË KUPËN E BOTËS DHE FUTBOLLIN MODERN

Nju - Jork, 12 qershor - Kupa e Botës 2026 do të sjellë gjashtë rregulla të reja që mund të ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e turneut që po mbahet në Shtetet e Bashkuara, Meksikë dhe Kanada.

Më herët gjatë këtij viti, Bordi Ndërkombëtar i Shoqatës së Futbollit (IFAB) ka njoftuar një sërë ndryshimesh me synimin për të rritur ritmin e lojës dhe për të përmirësuar përvojën e tifozëve dhe lojtarëve. IFAB është organi përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregullave të futbollit, ndërsa ish-gjyqtari i njohur Pierluigi Collina, aktualisht shef i gjyqtarëve në FIFA, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e këtyre ndryshimeve.

Një nga risitë më të mëdha lidhet me zgjerimin e kompetencave të VAR-it, i cili tashmë mund të ndërhyjë për të korrigjuar kartonët e dytë të verdhë të dhënë gabimisht, si dhe goditjet nga këndi të akorduara në mënyrë të pasaktë.

Këto janë gjashtë rregullat e reja

Zëvendësimet më të shpejta: Lojtarët që zëvendësohen do të kenë vetëm 10 sekonda kohë për të dalë nga fusha. Nëse e tejkalojnë këtë afat, futbollisti që pret të hyjë në lojë do të duhet të presë një minutë shtesë para se të lejohet të futet në fushë.

Numërim mbrapsht për rivëniet në lojë: Gjyqtarët do të përdorin një numërim të dukshëm prej pesë sekondash për autet dhe goditjet nga porta. Nëse një skuadër nuk e ekzekuton autin brenda afatit, topi do t'i kalojë kundërshtarit. Në rast se vonohet goditja nga porta, kundërshtari do të fitojë një goditje nga këndi.

Lojtarët e trajtuar do të qëndrojnë jashtë fushës: Futbollistët që marrin ndihmë mjekësore në fushë do të duhet të qëndrojnë jashtë lojës për 60 sekonda para se të rikthehen, përveç rasteve të veçanta që parashikohen nga rregullorja.

Kompetenca të reja për VAR-in: VAR-i tashmë do të mund të korrigjojë kartonët e dytë të verdhë të dhënë gabimisht dhe vendimet e pasakta për goditjet nga këndi.

VAR-i do të kontrollojë edhe faullet para rivënieve në lojë: Teknologjia mund të ndërhyjë nëse konstatohet një faull para se topi të futet në lojë gjatë një goditjeje standarde.

Karton i kuq për mbulimin e gojës në përplasje: Çdo lojtar që mbulon gojën gjatë një konfrontimi me kundërshtarin mund të ndëshkohet me karton të kuq, si pjesë e masave për të parandaluar sjelljet e papërshtatshme dhe mungesën e transparencës në komunikim.

Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereza"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"
10 000 Prishtinë Rr.ULPIANA U1/1 pn. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.nenatereza.org e mail:ntereze@yahoo.com

CONTRACT AWARD NOTICE

SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 12/06/*2026*

Procurement No	Training	001	2026	221

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English ☒

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name:Kosovo Humanitarian Charitable Society " Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town:*Prishtina*	Postal code:10000	Country:Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone:044-128-277	
Email:zefshala@hotmail.com	Fax:038-542-865	
Internet address (*if applicable*):	www.matherteresasociety.org	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Profesional training for 400 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Chooseone category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

		☒Services
		Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Profesional training for 400 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots **NO** ☒

II.1.7)Contract value: 24,990.00 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

☐ **Open**

III.2) AWARD CRITERIA

☐**Lowest Price**

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 12/06/2026

IV.2) Intended date of contract signing 15/06/2025

IV.3) Number of received tenders 5

IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded

Official name: "D&D" Business Support Centre " L.L.C. Prishtinë		
Postal address: 10000 Pristine		
Town: *Pristine*	Postal code:10000	Country: Kosovo
URL (*if applicable*):		
Contact point(s): Safet Fazliu	Email:info@dd-bsc.com	
Telephone:	Fax:	

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 29,106.00 Euro
Responsive tender with lowest price: 29,106.00 Euro_
Responsive tender with highest price: 36,613.00 Euro_

IV.6) The contract is likely to be subcontracted **No** ☐

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092 ,at the address specified in Section I of this Contract award notice.

Uniteti

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Kryeshefes Ekzekutive të datës 12.06.2026 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 12.06.2026 të shpall:

KONKURS

Një (1) Vozitës i kategorisë "C"- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.
Numri i referencës: 12-06-289
Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme
Lartësia e pagës mujore: 542.89 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhëresës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhëresën e Punës në të cilën evidencon punët e kryera , vërejtejet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letrën e re të tahografit ndërsa letrën paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letrën e tahografit ka obligim që në të të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon,largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresen e punës;
- Në rast nevoje ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjëshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtpërdrejtë;
- Vozitësi e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jasht planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhëresës së udhëhqësit drejtëprdrejt, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:
Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.
Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).
Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe ne bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.
Kandidatë fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.
Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës se rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:
Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 13.06.2026 deri me 27.06.2026, ora 16:00.
Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com
Vërejtje: Aplikacionet e pakompletuara, si dhe apliakcionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar në shpallje, nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artiol Bekteshi shpall të pavlefshme dëftesën kl. 11 të shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Leona Dërmaku shpall të pavlefshme dëftesën kl. 10 të shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Flemingo Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.

- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl .VI - IX sh.f.m.u. " Ibrahim Fehmiu" Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.

- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjuraj nga Gërqina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.
- Fitim Syla shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.

- Vilson Gjykaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U "Engjëll Gjoni", Novosellë, nga klasa 1-8.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE
Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Rregullores për Procedurat e Punësimit dhe Menaxhimit të Marrëdhënies së Punës në NPB – SH.A. Prishtinë, Nr. Protokolli: 01-143/2, datë 10 Shkurt 2026 dhe Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës Nr. Protokolli: 01-336/2, datë 11 Mars 2025, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Punëtor/e në Njësinë për Pastrim 9 (nëntë) pozita.

I raporton: Kryepunëtorit/es në Njësinë për Pastrim
Niveli i pagës:: 8.1
Orët e Punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e Kontratës: Me kohë të caktuar 12 muaj (puna provuese 6 muaj)
Vendi Punës: Rr. "Zija Shemsiu" nr. 22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat e përgjegjësitë:

a) Është përgjegjës/e për realizimin e objektivave të caktuara nga Kryepunëtori/ja i/e grupit;
b) Koordinon punët me punonjësit/et tjerë/a së bashku me Kryepunëtorin/en i/e grupit në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me Njësinë për Pastrim (NJP);
c) Bashkëpunon ngushtë me punonjësit/et tjerë/a dhe me kryepunëtorin/en e grupit në përmbushjen e objektivave të Divizionit të Mirëmbajtjes së Rregullt dhe Intervenimeve (DMRrI-së);
d) Merr pjesë në mbledhjet e rregullta ku është i/e thirrur për nevojat e Divizionit;
e) Është përgjegjës/e për pastrimin e njësive të përbashkëta të banesave kolektive të përcaktuara nga Kryepunëtori/ja;
f) Mban evidencë të njësive të pastruara dhe e dorëzon këtë raport në baza javore të Kryepunëtori/ja i/e grupit të pastrimit;
g) Për punët dhe detyrat e shtruara i përgjigjet kryepunëtorit/es të/së grupit të pastrimit;
h) Porositë për materiale i bën më herët dhe i specifikon në detaje sipas kërkesës;
i) Materialet të cilat nuk furnizohen sipas kërkesës ka të drejtë t'i kthejë mbrapa;
j) Kujdeset për mjetet e punës dhe raporton për defektet e tyre;
k) Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar;
l) Kryepunëtori/ja i/e grupit të pastrimit mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së;
m) Në rast mungese të punonjësve tjerë, me urdhër të mbikëqyrësit mund të zëvendësojë dhe të kryej detyra tjera.

Kualifikimet:
• Shkollimi fillor;
• Preferohet përvojë pune së paku 1 vit.

Aftësitë:
• Shkathtësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë;
• Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me pastrim;
• Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për sigurinë në punë;
• Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në objekte të ndryshme;
• Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në të gjitha kushtet atmosferike.
• Të ketë etikë dhe integritet në punë.

Mënyra e aplikimit;
Aplikimi për këtë konkurs mund të bëhet në mënyrë elektronike, duke dërguar dokumentacionin e kërkuar në adresën zyrtare: burimet.njerezore@npbanesore.com. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të bashkëngjitura në formatin PDF.
Aplikimi mund të dorëzohet gjithashtu në formë fizike pranë Divizionit të Burimeve Njerëzore.
Kandidatët që aplikojnë janë të obliguar të shënojnë saktë adresën e banimit, numrin e telefonit kontaktues si dhe adresën elektronike (e-mail).
Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs do të ftohen në fazat e mëtejshme të procedurës së rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- Diplomë e Shkollimit fillor;
- Dëshmia mbi përvojën e punës 1 vit - preferohet;
- Kurse dhe trajnime tjetra gjate karrierës profesionale - preferohet;
- Jetë Përshkrimi (CV);
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon që nuk jeni i/e dënuar apo nën hetime (duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psiqike para nënshkrimit të kontratës (vetëm kandidati/ja i/e përzgjedhur)

***Shënim:**. Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs nuk pranohen.*

Aplikimet e dorëzuara pa nënshkrimin e formularit të aplikimit dhe me qoftë vetëm një dokument të munguar do të refuzohen automatikisht.

Ndërmarrja Publike Banesore ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Njoftim PËR PRIVATËSINË DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE
Ndërmarrja Publike Banesore SHA Prishtinë – NPB SHA Prishtinë, me seli në Prishtinë, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, informon kandidatët për punën lidhur me përpunimin e të dhënave personale gjatë procesit të rekrutimit.

1. Qëllimi i përpunimit:
Të dhënat personale përpunohen me qëllim të:
- Zhvillimit të procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes;
- Verifikimit të kualifikimeve profesionale;
- Ushtrimit të së drejtës së ankesës;
- Themelimit të marrëdhënies së punës për kandidatët e përzgjedhur.

2. Llojet e të dhënave që përpunohen:
- Të dhënat identifikuese (emër, mbiemër, datëlindje, numri personal);
- Të dhënat e kontaktit;
- Të dhënat mbi arsimin dhe përvojën profesionale;
- Dokumentet mbështetëse të aplikimit;
- Të dhëna të tjera të kërkuara sipas konkursit.

3. Baza ligjore:
Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje të plotë me:
- Ligjin Nr. 06–L/062, datë 30 Janar 2019, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale[1];
- Ligjin Nr. 03/L–212, datë 01 Nëntor 2010, I Punës[2].
- Ligjin Nr. 03/L–087, datë 13 Qershor 2008, Për Ndërmarrjet Publike[3], i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L–111, datë 20 Prill 2012[4] dhe Ligjin Nr. 05/L–009, datë 07 Prill 2015[5];
- Rregulloren Për Mbrojtjen e të Dhënave[6] në NPB SHA Prishtinë, si dhe aktet nënligjore të brendshme.

4. Afati i ruajtjes:
- Të dhënat personale të kandidatëve që me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procedurës së rekrutimit pjesërisht apo në tërësi, ruhen deri në tridhjetë (30) ditë, nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat personale të kandidatëve të papërzgjedhur ruhen deri në një (1) vit nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat e kandidatëve të përzgjedhur ruhen në dosjen personale gjatë marrëdhënies së punës dhe më pas sipas legjislacionit arkivor.

5. Qasja dhe siguria.Të dhënat personale përpunohen vetëm nga persona të autorizuar dhe m brohen me masa teknike e organizative të përshtatshme.

6. Të drejtat e kandidatëve: Kandidatët kanë të drejtë:Të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre;Të kërkojnë qasje në të dhënat e tyre, korrigjim ose fshirje të tyre sipas ligjit;Të paraqesin ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

7. Kontakti:
Për pyetje lidhur me përpunimin e të dhënave personale, kandidatët mund të kontaktojnë:
NPB SHA Prishtinë – Divizioni i Burimeve Njerëzore.
📍 **Lagje** "ULPIANA", **Rr.** "Zija SHEMSIU", **Nr.** 22, 10000, Prishtinë.
📧 burimet.njerezore@npbanesore.com

Shpallja është e hapur që nga data 12.06.2026 deri më 26.06.2026 në ora 23:59.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel.: 038 553 311.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Na osnovu odredbi člana 8. Zakona o radu, Pravilnika o postupcima zapošljavanja i upravljanju radnim odnosima u NPB – AD Priština, br. Protokol: 01-143/2, od 10. februara 2026. godine i Pravilnika o sistematizaciji radnih mesta br. Protokol: 01-336/2, od 11. marta 2025. godine, Javno stambeno preduzeće AD u Prištini, objavljuje:

KONKURS
Za popunjavanje radnog mesta

Naziv posla: Radnik jedinice za čišćenje 9 (devet) pozicija.

Izveštava: Šefu jedinice za čišćenje

Nivo plate: 8.1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje ugovora: Na određeno vreme 12 meseci (probni period od 6 meseci)

Mesto rada: Ulica „Zija Šemsiju" br. 22, Ulpjana - Priština (sedište Javnog stambenog preduzeća)

Dužnosti i odgovornosti:

a) Odgovoran je za ostvarivanje ciljeva koje je postavio Šef grupe;

b) Koordinira rad sa ostalim zaposlenima zajedno sa Šefom grupe u vezi sa zahtevima i potrebama za obavljanje neophodnih aktivnosti vezanih za Jedinicu za čišćenje (JČ);

c) Tesno sarađuje sa ostalim zaposlenima i šefom grupe u ispunjavanju ciljeva Odeljenja za redovno održavanje i intervencije (ODOI);

d) Učestvuje na redovnim sastancima na koje je pozvan za potrebe Odeljenja;

e) Odgovoran je za čišćenje zajedničkih jedinica kolektivnog stanovanja koje odredi poslovođa;

f) Vodi evidenciju o očišćenim jedinicama i nedeljno dostavlja ovaj izveštaj poslovođi grupe za čišćenje;

g) Odgovoran je za dodeljene zadatke i dužnosti poslovođi grupe za čišćenje;

h) Naručuje materijale unapred i detaljno ih specificira na zahtev;

i) Ima pravo da vrati materijale koji nisu isporučeni na zahtev;

j) Brine o alatima za rad i izveštava o njihovim nedostacima;

k) Odgovoran je za upotrebljeni materijal;

l) Poslovođa grupe za čišćenje može mu/joj dodeliti druge zadatke prema potrebama NPB-a;

m) U slučaju odsustva drugih zaposlenih, po nalogu rukovodioca, može ih zameniti i obavljati druge zadatke.

Kvalifikacije:

• Osnovno obrazovanje;

• Poželjno je najmanje 1 godina radnog iskustva.

Veštine:

• Sposobnost za rad u grupi, pod pritiskom i pokazivanje fleksibilnosti na radu;

• Odlično poznavanje materijala i alata za rad vezanih za čišćenje;

• Biti izuzetno oprezan i poštovati bezbednosne standarde na radu;

• Biti spreman za rad u različitim objektima;

• Biti spreman za rad u svim vremenskim uslovima.

• Imati etiku i integritet na radu.

Kako se prijaviti;

Prijava za ovaj konkurs može se izvršiti elektronski, slanjem potrebne dokumentacije na zvaničnu adresu: njerezore.njerezore@npbanesore.com. Sva dokumenta moraju biti priložena u PDF formatu.

Prijava se može podneti i u fizičkom obliku Odeljenju za ljudske resurse.

Kandidati koji se prijavljuju su dužni da tačno navedu adresu stanovanja, kontakt telefon i elektronsku adresu (e-poštu).

Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume navedene u konkursu biće pozvani u dalje faze postupka zapošljavanja.

Dokumenta koja moraju biti priložena:

• Prijava za NPB;

• Diploma o završenom osnovnom obrazovanju;

• Poželjan je dokaz o jednogodišnjem radnom iskustvu;

• Poželjni su drugi kursevi i obuke tokom profesionalne karijere;

• Biografija (CV);

• Uverenje o krivičnom dosijeu izdato od strane suda, kojim se dokazuje da niste osuđivani ili da ste pod istragom (ne sme biti starije od šest meseci);

• Kopija lične karte;

• Lekarsko uverenje da ste u dobrom fizičkom i mentalnom zdravlju pre potpisivanja ugovora (samo za izabrane kandidate)

Napomena: Prijave koje stignu nakon roka navedenog u konkursu neće biti prihvaćene.

Prijave podnete bez potpisanog prijavnog formulara i sa čak i jednim nedostajućim dokumentom biće automatski odbijene.

Javno stambeno preduzeće nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo i prima prijave svih osoba oba pola i iz svih zajednica u Republici Kosovo.

OBAVEŠTENJE O PRIVATNOSTI I OBRADI LIČNIH PODATAKA

Javno stambeno preduzeće SHA Priština – NPB SHA Priština, sa sedištem u Prištini, u svojstvu kontrolora ličnih podataka, obaveštava kandidate o poslovima vezanim za obradu ličnih podataka tokom procesa zapošljavanja.

1. Svrha obrade:

Lični podaci se obrađuju u svrhu:

• Razvoja postupka zapošljavanja i selekcije;

• Provere stručnih kvalifikacija;

• Korišćenja prava na žalbu;

• Zasnivanja radnog odnosa za izabrane kandidate.

2. Vrste podataka koji se obrađuju:

• Identifikacioni podaci (ime, prezime, datum rođenja, lični broj);

• Kontakt podaci;

• Podaci o obrazovanju i stručnom iskustvu;

• Prateća dokumentacija za prijavu;

• Ostali podaci koje zahteva konkurs.

3. Pravni osnov:

Obrada ličnih podataka se vrši u potpunosti u skladu sa:

• Zakonom br. 06–L/062, od 30. januara 2019. godine, o zaštiti ličnih podataka;

• Zakon br. 03/L–212, od 1. novembra 2010. godine, o radu.

• Zakon br. 03/L–087, od 13. juna 2008. godine, o javnim preduzećima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L–111, od 20. aprila 2012. godine i Zakonom br. 05/L–009, od 7. aprila 2015. godine;

• Pravilnik o zaštiti podataka u NPB SHA Priština, kao i interni podzakonski akti.

4. Period čuvanja:

• Lični podaci kandidata koji dobrovoljno ne prođu kroz postupak zapošljavanja delimično ili u potpunosti čuvaju se do trideset (30) dana od završetka postupka zapošljavanja.

• Lični podaci neizabranih kandidata čuvaju se do jedne (1) godine od završetka postupka zapošljavanja.

• Podaci izabranih kandidata čuvaju se u ličnom dosijeu tokom radnog odnosa i nakon toga u skladu sa arhivskim propisima.

5. Pristup i bezbednost. Lične podatke obrađuju samo ovlašćena lica i zaštićeni su odgovarajućim tehničkim i organizacionim merama.

6. **Prava kandidata: Kandidati imaju pravo: Da budu obavešteni o obradi svojih podataka; Da zahtevaju pristup svojim podacima, ispravku ili brisanje u skladu sa zakonom; Da podnesu žalbu Agenciji za informacije i privatnost**.

7. Kontakt:

Za pitanja u vezi sa obradom ličnih podataka, kandidati mogu kontaktirati:

NPB SHA Priština – Odeljenje za ljudske resurse.

Naselje „ULPIANA", ulica „Zija SHEMSIU", br. 22, 10000, Priština.

brvet.njerezore@npbanesore.com

Oglas je otvoren od 12.06.2026. do 26.06.2026. u 23:59.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati Odeljenje za ljudske resurse Javnog stambenog preduzeća na broj telefona: 038 553 311.

100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË

ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES